



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1017/22

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami anëtarë të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit MSS Mobile Sanitary Service, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati K. P., nga Prishtina, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit të organit të paditur, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.196/17, të datës 16.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.11.2023, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e bazuar ankesa e të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP). Ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.196/17, i datës 16.03.2021, vërtetohet.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar, e ka Aprovuar si të bazuar kërkesëpadia e paditësit MSS Mobile Sanitary Service Sh.P.K me seli në Prishtinë. Pika e II dispozitivit Anulohet vendimi i të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit OSHP në Prishtinë, PSH.Nr.411/2016, 413/2016, 416/16, 417/17 të

datës 27.12.2016 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor, ankesë ka ushtruar e paditura, për shkak të vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet ankesa e të paditurit, Organit Shqyrtues i Prokurimit si e bazuar ndërsa Aktgjykimi Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative A.Nr.196/17 datë 16.03.2021, të anulohet si i pabazuar dhe njëherit të refuzohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit MSS Mobile Sanitary Service Sh.P.K me seli në Prishtinë.

Përgjigje në ankesë paditësi nuk ka parashtruar edhe pse të njëjtën e ka pranuar me datë 05.05.2021.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi ankesën e paditësit, aktgjykimin e ankimuar, si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49, të Ligjit për Konfliktet Administrative, ( LKA ),dhe neni 194 të LPK-së, ligj i zbatueshëm si në vështrim të nenit 63 të LKA, gjen se;

Ankesat janë të pabazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin PSH.Nr.411/2016, 413/2016, 416/16, 417/17 të datës 27.12.2016, në pikën I të dispozitivit ka vendosur të Aprovohen pjesërisht si të bazuara ankesat e OE “Nptsh Omi Impex” – Suharekë me nr.417/16, OE “Uni Project” Prishtinë me nr.411/16, e OE “MSS – Mobile Sanitary Serviles Sh.P.K” – Prishtinë me nr.413/16 dhe OE “Npt Beni & Euroing ShPK” – Suharekë me nr.413/16, përkitazi me aktivitetin e prokurimit “Kontratë kornizë – Shërbime të pastrimit”, Lot.1,7,8,9,10” me nr. prok. AQP/15/010/211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP). Në pikën II të dispozitivit ka anuluar vendim i AK-së, për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e Prokurimit “Kontratë kornizë – Shërbime të pastrimit, Lot,1 dhe 10 me nr.prok. 15/010/211, inisuar nga autoriteti kontraktues Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) dhe Lënda për Lot 1 dhe 10 kthehet në Ri-vlerësim. Në pikën III të dispozitivit, vërtetohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e

Prokurimit “Kontratë kornizë – Shërbime të pastrimit Lot.7, 8 dhe 9 me nr.prok. 15/010/211, iniciuar nga autoriteti kontraktues Agjencia Qëndrore e Prokurimit (AQP). Në pikën III Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitetet të prokurimit. Në pikën IV të dispozitivit Meqenëse pretendimet ankimore të operatorëve ekonomik ankues janë pjesërisht të qëndrueshme, iu kthehet sigurimi i ankesës në vlerën e deponuar me rastin e parashkrimit të ankesës. Në pikën V, Obligohet OE ankues që konform nenit 36 pika 5 e Rregullores të Punës së OSHP-së në afat prej gjashtëdhjetë ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

I pakënaqur me vendimin e të paditurës, paditësi me padi inicion konflikt administrativ në Gjykatën e shkallës së parë e cila në këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesor në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Në arsyetim ndër të tjera ka theksuar se nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative LPA i cili ka qenë në fuqi në kohën e vendosjes lidhur me ankesën e paditësit. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par.2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbaj përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruar nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj parashihet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtën dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara ose janë në kundërshtim menjë informacion apo propozim zyrtar. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit. Në arsyetimin e vendimit theksohet se bazuar në të gjitha konstatimet dhe sqarimet e dhëna gjatë shqyrtimit të kësaj lënde, eksperti shqyrtues teknik në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP ka rekomanduar që autoritetit

kontraktues – Agjencia Qendrore e Prokurimit, të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit “Shërbime të Pastrimit” Lot 1,7,8,9,10 ku në këtë rast nga eksperti nuk mund të konstatohet që jepet as një raport kronologjik referuar pretendimeve, por se të njëjtat konstatohen si të vlerësuara të pa bazuara ankesat nga eksperti i OSHP-së dhe se konstatohet se i njëjti ka rekomanduar vazhdimin e aktivitetit të prokurimit ku përfshihen Lot 1,7,8,9, 10.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes duke shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në bazë të ankesës të paditurës dhe sipas detyrës zyrtare të njëjtin e konfirmon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar në prova dhe ligj. Aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të ligjit për konfliktet administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar administrativ në bazë të padisë, përgjigjes në padi provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor si dhe shkresave të tjera të lëndës si në vështrim të nenit 9, dhe 44 të LKA, dhe drejtë e ka vendosur çështjen me aprovimin të kërkesë padisë së paditësit, duke kthyer në rivendosje tek e paditura. Gjykata gjatë vlerësimit të vendimit të kontestuar, vëren të meta formale të cilat krijojnë konfuzion dhe paqartësi dhe që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit, pasi që në dispozitiv të vendimit aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesat e OE “Nptsh Omi Impex” – Suharekë me nr.417/16, OE “Uni Project” Prishtinë me nr.411/16, e OE “MSS – Mobile Sanitary Serviles Sh.P.K” – Prishtinë me nr.413/16 dhe OE “Npt Beni & Euroing ShPK” – Suharekë me nr.413/16, përkitazi me aktivitetin e prokurimit “Kontratë kornizë – Shërbime të pastrimit”, Lot.1,7,8,9,10” me nr. prok. AQP/15/010/211, kurse nuk përfshihen refuzimi përkitazi me pretendimet përtej atyre të aprovuara pjesërisht, kurse arsyetimi thekson konstatimin se ankesat janë të pa bazuara. Në arsyetimin e vendimit referuar ankesës së këtu paditësit lidhur me pretendimin ankimor se autoriteti kontraktues ka pasur një vendim të plotfuqishëm me të cilin është anuluar ky aktivitet i prokurimit dhe rrjedhimisht nuk është lejuar njoftimi për dhënien e kontratës për mendimin e ekspertit Teknik është pretendim i pa bazë, ku edhe në këtë raste e paditura bënë arsyetim të përgjithshëm si: “Pas marrjes së vendimit të OSHP-së ku anulohet vendimi i AK-së për anulim pasi që për panelin shqyrtues të OSHP-së ky vendim ka qenë i kundërligjshëm sepse paneli ka vlerësuar se ka qenë ndërhyrje e ZKA-së në kundërshtim me ligjin për anulimi të këtij tenderi, dhe për mos zbatim të vendimit të OSHP-së atëherë OSHP ka lëshuar Urdhëresë andaj sipas

urdhëresës të lëshuar AK ka bërë njoftimin për dhënien e kontratës për eliminimin e OE ankueses MSS, paneli shqyrtues ka konstatuar se nuk ka shkelje të LPP-së nga ana e AK-së por është bërë komfor kërkesave të njoftimit të kontratës dhe FDT” që për gjykatën një arsyetim i tillë i pa mbështetur në asnjë referim ligjor, duke mos pasur asnjë deklaram të bazës ligjore, një arsyetim i pa mbështetur as në mënyrë deklarative në asnjë provë, por se i njëjti konstaton se “paneli ka vlerësuar se ka qenë ndërhyrje e ZKA-së në kundërshtim me Ligjit për anulimin e këtij tenderi dhe për mos zbatimin e vendimit të OSHP”, por ky arsyetim nuk përmban bazën faktike dhe si ka ardhur deri te ky vlerësim, ndërhyrja e ZKA-së, referuar cilës dispozitë të ligjit ishte në kundërshtim po ashtu arsyetimi mbështet në një urdhëresë të cilës nuk i referohet bazë ligjore, numër apo datë.

Kolegji i kësaj gjykate duke i shqyrtuar dhe vlerësuar pretendimet ankimore të paditurës, të cilat konsistojnë në bazat e theksuara si më lartë, vlerëson se pretendimet e theksuara janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara, sepse nuk dëshkohet se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës administrative, apo të LKA-së. Kolegji i kësaj gjykate duke shqyrtuar lëndën edhe sipas detyrës zyrtare gjen se procedura në organin e paditur OSHP, dhe gjykatën e shkallës së parë është zhvilluar ashtu siç parashihet me ligj, ku janë nxjerrë prova të mjaftueshme për vendosjen e drejtë të çështjes.

Po ashtu, gjendja faktike nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar në mënyrë të plotë gjatë administrimit të provave në seancë të shqyrtimit kryesor, nga është vërtetuar se pretendimet e paditësit janë të pabazuara dhe në kundërshtim me gjendjen e vërtetuar faktike në organin e paditur dhe provave të cilat janë në shkresat e lëndës, nga këto fakte është vërtetuar se vendimi i organit të paditur është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të LPA-së, dhe LPP-së.

Mbi këtë gjendje të fakteve të provuara, kolegji i kësaj gjykate konstaton se çështja në shqyrtim nga gjykata e shkallës së parë, përkatësisht vlerësimi i ligjshmërisë së vendimit të organit administrativ përfundimtar është shqyrtuar në mënyrë të argumentuar në baza ligjore, andaj pretendimet ankimore kolegji i vlerësoi si të pa ndikim për tu vërtetuar gjendje tjetër faktike, dhe për të vendosur ndryshe nga ajo që është vendosur në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera të palëve ankuese në ankesa mirëpo të njëjtat ishin të pa bazuara dhe nuk kishin ndonjë ndikim në vendosje ndryshe, andaj edhe vendosi që aktgjykimin e shkallë së parë ta vërteton si të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga të lartë cekurat e në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 200 i LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë**

K.DH.SH.II.nr.1017/22, me datë 20.11.2023

Kryetare e kolegjit,  
Franciska Zhitija Ymeri